

**LIGJ**  
**Nr. 87/2018**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES  
SOCIALE TË SHQIPËRISË, DHE FONDIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA  
PËR POPULLSINË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.11.2018.

**Shpallur me dekretin nr. 10992, datë 13.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Ilir Meta**

**MARRËVESHJE BASHKËFINANCIMI**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË**  
**PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**TË SHQIPËRISË, DHE FONDIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA**  
**PËR POPULLSINË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Shqipërisë dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, të referuara bashkërisht si “Palët” dhe secila individualisht si “Palë”, bien dakord si më poshtë:

Neni 1  
**Përkufizime**

Në këtë Marrëveshje Bashkëfinancimi, termi:

“Bashkëfinancim” nënkupton modalitetin e mobilizimit të burimeve nëpërmjet të cilit kontributet pranohen nga UNFPA-ja në mbështetje të qëllimeve specifike, në përputhje me politikat, qëllimet dhe aktivitetet e UNFPA-së;

“Marrëveshje” nënkupton këtë Marrëveshje Bashkëfinancimi;

“Kontribut” nënkupton shumën totale të burimeve financiare, të cilat Donatori bie dakord t’i ofrojë UNFPA-së, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje;

“Donator” nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë;

“Partner zbatues” nënkupton subjektin të cilit UNFPA-ja i ka besuar zbatimin e aktiviteteve të programit të UNFPA-së, të përcaktuara në një dokument të nënshkruar, së bashku me

supozimin/marrjen përsipër të përgjegjësive dhe përgjegjshmërisë së plotë për përdorimin efektiv të burimeve të UNFPA-së dhe arritjen e rezultateve, siç përcaktohet në dokumentacionin e programit;

“Raport i auditimit të brendshëm” nënkupton raportin përfundimtar që rezulton nga një auditim i nënshkruar nga drejtori i Divizionit për Shërbimet e Mbikëqyrjes të UNFPA-së dhe i lëshuar drejtorit ekzekutiv dhe të audituarve për shqyrtimin e tyre dhe për zbatimin e rekomandimeve. Raporti i është dhënë, gjithashtu, Bordit të Audituesve të Kombeve të Bashkuara.

“Program” nënkupton aktivitetet që do të financohen, në tërësi ose pjesërisht, nga Kontributi;

“Burime të rregullta” nënkupton burime të disponueshme për UNFPA-në, të cilat janë të pezuluara dhe të palidhura/pa kufizime. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në kontributet, të ardhurat e interesit dhe të ardhurat e ndryshme;

“UNFPA” nënkupton Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, një organ vartës i Kombeve të Bashkuara i themeluar nga Asambleja e Përgjithshme në rezolutën 3019 (XXVII).

## Neni 2

### **Dokumentet e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje Bashkëfinancimi përbëhet nga kjo Marrëveshje dhe shtojca 1 bashkëlidhur, e cila përshkruan Programin.

## Neni 3

### **Kontributi**

1. Donatori do të japë kontributin e mëposhtëm në mbështetje të Programit: Njëzet e dy milionë e pesëqind mijë lekë (22,500,000 lekë).

2. Donatori do të transferojë Kontributin në llogarinë bankare në vijim:

PNUD (në emër të zyrës vendore të UNFPA-së në Shqipëri)

Emri i Përfituesit: PNUD

Emri i Bankës: Banka Intesa San Paolo

IBAN: AL60208110080000001003730902 (LEK)

KODI SWIFT: USALALTRXXX

3. Donatori do të transferojë shumën e plotë të Kontributit kur Marrëveshja të hyjë në fuqi dhe siç deklarohet në nenin IX, pika 1.

4. Donatori do të informojë UNFPA-në, pa vonesa të panevojshme, kur Kontributi apo ndonjë pjesë e tij të jetë paguar, me anë të postës elektronike, me informacion mbi remitancën në adresën: [rmb@unfpa.org](mailto:rmb@unfpa.org)

5. Nëse Kontributi bëhet në një monedhë të ndryshme nga dollari amerikan, vlera ekuivalente e saj në dollarë amerikanë do të përcaktohet duke zbatuar shkallën operative të këmbimit valutor të Kombeve të Bashkuara në fuqi, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, nëse një normë tjetër operationale e këmbimit valutor të Kombeve të Bashkuara zbatohet në kohën e marrjes së çdo pagese në lidhje me Kontributin, vlera e pagesës do të përcaktohet duke zbatuar shkallën operative të Kombeve të Bashkuara, në fuqi në datën e pranimit të pagesës nga UNFPA dhe shuma e kontributit në dispozicion për aktivitetet e Programit do të rregullohet në përputhje me rrethanat, për të pasqyruar fitimin ose humbjen rrjedhuese.

6. Në rast të ndonjë rrethane të paparashikuar që lidhet me ose ka ndikim në vlerën e kontributit, duke përfshirë rritjet e paparashikuara të shpenzimeve ose angazhimeve financiare, faktorit të inflacionit ose luhatjeve në kurset e këmbimit valutor, UNFPA-ja mund të kërkojë financim të mëtejshëm nga donatori. Nëse financimi i mëtejshëm nuk është i disponueshëm ose i afërt nga donatori, aktivitetet në kuadër të Programit mund të reduktohen, pezullohen ose ndërpriten nga UNFPA-ja. UNFPA-ja nuk do të jetë përgjegjëse për të vënë në dispozicion një financim të tillë të mëtejshëm.

## Neni 4

## **Administrimi i Kontributit**

1. UNFPA-ja do të administrojë Kontributin në përputhje me rregulloret, rregullat, politikat dhe procedurat financiare të UNFPA-së, duke përfshirë ato që lidhen me interesin dhe investimet.

2. Të gjitha shpenzimet e drejtpërdrejta të Programit, duke përfshirë të gjitha shpenzimet në lidhje me zbatimin e Programit nga një partner zbatues, do të identifikohen në buxhetin e Programit dhe, si rrjedhojë do të mbulohen nga Programi. Gjithashtu, kontributi do t'i nënshtrohet një kompensimi të shpenzimeve të tërthorta të UNFPA-së në një shumë prej 5% (pesë për qind) të shpenzimeve totale të shkaktuara nga Kontributi.

Neni 5

### **Raportimi**

1. UNFPA-ja do t'i paraqesë donatorit:

a) Një raport progresi brenda 3 (tre) muajve pas përfundimit të çdo viti kalendarik;  
b) Një raport përfundimtar të progresit brenda gjashtë muajve nga data e përfundimit operacional të Programit ose, në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, pas një ndërprerjeje të tillë;

c) Një pasqyrë financiare vjetore të vërtetuar nga një zyrtar i autorizuar i UNFPA-së (Dega e Financës, Divizioni për Shërbimet e Menaxhimit) më 31 dhjetor të vitit në fjalë, e cila do të dorëzohet jo më vonë se data 30 qershor e vitit pasues;

d) Një pasqyrë përfundimtare financiare të vërtetuar nga një zyrtar i autorizuar i UNFPA-së (Dega e Financës, Divizioni për Shërbimet e Menaxhimit), e cila do të dorëzohet jo më vonë se data 30 qershor pas vitit në të cilin Programi është përfunduar në mënyrë operationale.

2. Raportet, sipas paragrafit 1 (a) dhe (b) të këtij neni do të përfshijnë informacione financiare dhe të përkohshme financiare. Përveç kërkesave të raportimit të përcaktuara në paragrafin 1 (a) deri (d) të këtij neni, UNFPA-ja bie dakord ta mbajë donatorin të informuar për çështjet kryesore, progresin dhe problemet që lidhen me Programin, sipas rastit.

3. Të gjitha raportet ose deklaratat e referuara në këtë nen do të shprehen në dollarë amerikanë. Në rast se donatorët e tjerë kanë kontribuar në Program, raportet sipas paragrafit 1 (a) deri (d) të këtij neni do të konsolidohen.

Neni 6

### **Vlerësimi**

Vlerësimi i Programit do t'u nënshtrohet dispozitave të përfshira në Politikën e Vlerësimit të UNFPA-së, të miratuara nga Bordi Ekzekutiv i UNFPA-së.

Neni 7

### **Auditimi**

1. Kontributi do t'u nënshtrohet ekskluzivisht dispozitave për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm të parashikuara në rregulloret financiare, rregullat, politikat dhe procedurat e UNFPA-së.

2. Ndarja e raporteve të auditimit të brendshëm me të tjerë duhet t'u nënshtrohet vendimeve dhe udhëzimeve të zbatueshme të Bordit Ekzekutiv të UNFPA-së.

Neni 8

### **Procedurat në lidhje me pretendimet për korrupsion**

1. UNFPA-ja pranon se është e rëndësishme që të merren të gjitha masat e nevojshme për të shmangur praktikat korruptive, mashtruese, bashkëpunuese ose shtrënguese. Për këtë qëllim, UNFPA-ja do të sigurojë standardet e sjelljes në lidhje me performancën e personelit të saj, duke përfshirë ndalimin e praktikave korruptive, mashtruese, bashkëpunuese ose shtrënguese në lidhje me dhënien dhe administrimin e kontratave, granteve ose përfitimeve të tjera, në rregulloret e

tyre të personelit dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara, Rregulloret Financiare dhe Rregullat e UNFPA-së, dhe procedurat e prokurimit të UNFPA-së. Në rast se UNFPA-ja përcakton se një pretendim në lidhje me zbatimin e programit, duke përfshirë praktikat korruptive, mashtruese, bashkëpunuese ose shtrënguese, është aq i besueshëm sa për të kryer një hetim, ai do të njoftojë menjëherë donatorin, nëse një njoftim i tillë nuk rrezikon zhvillimin e hetimit. Pretendimi do të trajtohet në përputhje me kuadrin e llogaridhënies dhe të mbikëqyrjes të UNFPA-së dhe nga njësia përgjegjëse për hetimet në UNFPA.

2. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Praktikë korruptive” nënkupton ofrimin, dhënien, marrjen ose kërkimin, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, të çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrën jo të duhur në veprimet e një zyrtari publik;

b) “Praktikë mashtruese” nënkupton çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin, që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose synon të mashtrtojë një palë për përfitim financiar ose ndonjë përfitim tjetër, ose për të shmangur një detyrim;

c) “Praktika bashkëpunuese” nënkupton një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve, e hartuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin në mënyrën jo të duhur në veprimet e një pale tjetër;

d) “Praktika shtrënguese” nënkupton përkeqësimin ose dëmtimin apo rrezikun për të përkeqësuar apo për dëmtuar drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë çdo palë ose pronë të palës për të ndikuar në mënyrën jo të duhur në veprimet e një pale.

#### Neni 9

### **Hyrja në fuqi, afati, përfundimi**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën kur Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do ta informojë UNFPA-në për ratifikimin parlamentar të kësaj Marrëveshjeje.

2. Donatori, në varësi të ratifikimit parlamentar të kësaj Marrëveshjeje, vë në dispozicion Kontributin, i cili do të përdoret ekskluzivisht për të financuar aktivitetet e përshkuara ose të përmendura në këtë “Marrëveshje”.

3. Ajo do të mbetet në fuqi për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh dhe do të skadojë në fund të ditës së fundit të kësaj periudhe, nëse nuk zgjatet me shkrim nga palët. Nënkuptohet që çdo vonesë nga donatori, e pagesës së parë që lidhet me Kontributin do t’i shtohet periudhës së kohëzgjatjes të kësaj Marrëveshjeje.

4. Secila Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje, duke i dhënë njoftim me shkrim 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike para Palës tjetër.

#### Neni 10

### **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje, konflikt ose pretendim që rrjedh nga ose që lidhet me këtë Marrëveshje, do të zgjidhet me anë të konsultimit ndërmjet palëve.

#### Neni 11

### **Dispozita përfundimtare**

1. Çdo balancë e pashpenzuar e mbetur pas mbylljes financiare të Programit do të zbatohet si më poshtë:

a) Nëse balanca nga kontributi i donatorit nuk tejkalon 5,000 US\$, ajo do të kreditohet në burimet e rregullta të UNFPA-së;

b) Nëse balanca nga kontributi i donatorit tejkalon 5,000 US\$, ajo do të kreditohet në një program tjetër të UNFPA-së, siç është rënë dakord ndërmjet Palëve.

2. Pavarësisht nga skadimi ose përfundimi i kësaj Marrëveshjeje, UNFPA-ja mund të zbatojë çdo pjesë të papërdorur të Kontributit, për të lejuar përfundimin e rregullt të aktiviteteve të Programit, duke përfshirë përfundimin e raporteve përfundimtare, tërheqjen e personelit, fondeve dhe pronës,

shlyerjen e llogarive ndërmjet Palëve dhe shlyerjen e detyrimeve kontraktuale, në lidhje me çdo partner zbatues, kontraktues, nënkontraktues, konsulentë ose furnitorë.

3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim të Palëve.

4. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të konsiderohet si heqje dorë, e shprehur apo e nënkuptuar, nga

cilido privilegj dhe imunitet i Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë UNFPA-në.

5. Kjo marrëveshje hartohet në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Versioni i gjuhës angleze do të ketë përparësi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, përfaqësuesit e autorizuar të Palëve, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në dy kopje.

**Për Këshillin e Ministrave  
të përfaqësuar nga Ministri i  
Shëndetësisë dhe Mbrojtjes  
Sociale:**

**Për Fondin e Kombeve të  
Bashkuara për Popullsinë:**

Data:

Data 11.7.2018

(Nënshkrimi)

(Titulli)

(Titulli) UNFPA County Directore

### SHTOJCË 1

## STUDIMI DEMOGRAFIK DHE SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI, 2017–2018 (ADHS 2017–2018)

Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri, 2017–2018, siguron të dhëna të shumta mbi treguesit demografikë dhe shëndetësorë të popullsisë shqiptare.

Bazuar në nevojën e përditësimit të të dhënave shëndetësore në vendin tonë, nevoja urgjente për realizimin e këtij studimi të dytë, ADHS 2017–2018, në Shqipëri, mori rëndësi të veçantë:

1. ADHS-ja realizohet në një kampion të madh dhe përfaqësues të popullatës dhe, si rrjedhojë rezultatet e këtij studimi janë të zbatueshme në të gjithë popullatën shqiptare.

2. ADHS 2017–2018 do të ofrojë të dhëna të vlefshme shëndetësore për shumë grup-mosha dhe kategori të rëndësishme të popullatës – të dhëna të cilat nuk ofrohen nga studime të tjera të këtij niveli.

Grup-moshat dhe kategoritë e mbuluara nga studimi ADHS përfshijnë:

a) Fëmijët e moshës 0–5 vjeç;

b) Gratë shtatzëna;

c) Gratë e moshës riprodhuese;

d) Individët në moshë madhore të të dyja gjinive.

3. ADHS-ja është një instrument shumë i rëndësishëm që siguron informacion për vlerësimin e programeve ekzistuese në vendin tonë.

Si shembull, ilustrues i rëndësishëm (dhe i kohëve të fundit) në këtë pikë mund të përmendet analiza e kosto-efektivitetit të Rotavirusit, ku për të dhënat në lidhje me imunizimin e popullatës, Ministria e Shëndetësisë dhe ISHP-ja iu referuan si burim kryesor informacionit të ADHS-së të vitit 2008–2009 dhe ky informacion u përdor për një vendimmarrje të rëndësishme, në lidhje me përfshirjen e Rotavirusit në kalendarin e vaksinimit për vitin 2017 e në vazhdim dhe miratimin e rritjes përkatëse të buxhetit të vaksinimit në vendin tonë.

4. Rezultatet e ADHS-së u ofrojnë vendimmarrësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por edhe shumë ministrive të tjera, informacionin e nevojshëm për hartimin e politikave dhe të strategjive të reja, si dhe modifikimin e programeve ekzistuese, në lidhje me shëndetin dhe shërbimet shëndetësore dhe sociale që i ofrohen popullatës shqiptare.

Të dhënat e studimit të parë të ADHS-së janë përdorur gjerësisht për hartimin e dokumenteve kryesore strategjike dhe politike, duke përfshirë dokumentet e miratuara kohët e fundit, si:

- a) Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë, 2016–2020;
  - b) Programi Kombëtar për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Infektive në Shqipëri, 2016–2020;
  - c) Plani i Veprimit të Promovimit Shëndetësor, 2017–2021;
  - d) Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues, 2017–2021.
- Gjithashtu, të dhënat e përfuara nga raundi i parë i ADHS-së janë reflektuar edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015–2020, të miratuar nga Këshilli i Ministrave në vitin 2016.

5. Rezultatet e studimit ADHS ndihmojnë partnerët dhe drejtuesit e programeve për të planifikuar ndërhyrjet e mëtejshme në fushën e shëndetit dhe mirëqenies së popullsisë shqiptare.

Aktualisht, institucione të rëndësishme partnere dhe mbështetëse si UNFPA-ja, Organizata Botërore e Shëndetësisë, UNICEF-ja, Banka Botërore dhe shumë organizata të tjera ndërkombëtare, të cilat operojnë në vendin tonë, u referohen gjerësisht të dhënave të raundit të parë të ADHS-së në hartimin e programeve dhe planifikimin e aktiviteteve të tyre në fushën e shëndetësisë. Megjithatë, duhet theksuar se raundi i parë i studimit është realizuar në periudhën 2008–2009 dhe të dhënat kanë nevojë për përditësim, fakt i cili argumenton edhe më shumë nevojën për ndërmarrjen e raundit të dytë të ADHS-së në vendin tonë.

6. Të dhënat e përfuara nga ADHS, 2017–2018, do të mundësojnë krahasimin e treguesve demografikë dhe shëndetësorë të popullsisë shqiptare në periudha kohore periodike. Gjithashtu, ADHS-ja do të mundësojë edhe krahasimin e të dhënave të vendit tonë me vendet e tjera.

7. Së fundi, por jo nga rëndësia, ADHS 2017–2018, do të kontribuojë në pasurimin e bazës së të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me tregues të rëndësishëm demografikë dhe shëndetësorë, të cilët do të ndihmojnë edhe në raportimet periodike që Shqipëria do të bëjë mbi treguesit e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDGs).

#### **Situata financiare e ADHS-së**

Buxheti i studimit dhe i aktiviteteve përkatëse është planifikuar nën mbështetjen e ekspertëve teknikë të ICF MACRO International dhe UNFPA-së. Partnerët kryesorë në mbështetjen financiare dhe teknike janë Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) nëpërmjet projektit HAP, UNFPA, UNICEF, UNWomen, ISHP dhe INSTAT.

Pasi ekspertët e ICF MACRO International filluan punën me grupin e ekspertëve vendës, ndërhyjnë duke bërë ndryshimet përkatëse në metodologjinë e studimit, në aktivitetet e studimit dhe arritën në një parashikim të koston financiare të studimit prej **1,418,500 dollarësh amerikanë**.

Në muajin gusht 2017, Komiteti Drejtues i ADHS-së u mblodh për të kryer një analizë dhe vlerësim të punës studimore, duke përfshirë edhe analizën e fondeve për zbatimin e këtij studimi. Komiteti Drejtues nxori përfundimin se nga kostoja totale e planifikuar prej 1,418,500 dollarësh amerikanë, financimi i studimit (duke përfshirë edhe kontributin modest të ISHP-së dhe INSTAT-it), ekziston sërish një mungesë në shumën prej **22,500,000 lekësh** të pambuluar.

Aktualisht, kontributet në koston direkte të ADHS-së, janë:

1. SDC (nëpërmjet projektit HAP), në vlerën 715,991 dollarë amerikanë;
2. UNFPA, në vlerën 200,000 dollarë amerikanë;
3. UNICEF, në vlerën 230,000 dollarë amerikanë;; UN Women, në vlerën 20,000 dollarë amerikanë;
4. ISHP, në vlerën 40,050 dollarë amerikanë;
5. INSTAT, 13,416 dollarë amerikanë.